

## **Kriteret që duhet të plotësojnë institucionet shëndetësore private për lidhjen e kontratës me Fondin**

**Kritere të përgjithshme** (Të detyruara për t'u përmbushur nga institucionet shëndetësore private për të gjitha paketat e shërbimeve )

Institucioni shëndetësor privat duhet të jetë:

- a. I licensuar nga Ministria e Shëndetësisë për dhënien e shërbimit shëndetësor që do të kontraktohet.
- b. I regjistruar pranë QKR dhe organeve tatimore në rrethin ku kryen aktivitetin.
- c. Me llogari bankare në një bankë të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë.
- d. I pajisur me pajisjet e nevojshme kompjuterike për të realizuar përpunimin elektronik të të dhënave, sipas programeve të përgatitura nga Fondi.
- e. Nuk duhet të jetë në procedurë falimentimi dhe likuidimi.

###

**Kritere të veçanta** (Kriteret e veçanta janë specifike sipas shërbimit që kontraktohet )

- **Për shërbimin e dializës**

- a. Institucioni shëndetësor privat, përveç shërbimit të dializës, duhet të ketë dhe laboratorin kliniko-biokimik e mikrobiologjik.
- b. Të ketë shërbim urgjence 24 orë.
- c. Të ketë aparatura dhe shtrat të veçantë për pacientët me hepatit të tipeve të ndryshme.
- d. Të ketë një aparat të transportueshëm të dializës, i cili të bëjë dhe hemodiafiltracion dhe biofiltracion.
- e. Të ketë në pronësi një autoambulancë në gjendje gadishmërie, me kohë të plotë.

###

- **Për shërbimet e kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë**

- a. Të ketë të paktën një mjek specialist të fushës së kardiologjisë dhe/ose një mjek specialist të kardiokirurgjisë të punësuar me kohë të plotë në institucion.
- b. Të ketë të paktën një shtrat (vend të lirë) të dedikuar për referimet urgjente që vijnë nga Fondi.
- c. Të ketë shërbim urgjence 24 orë.
- d. Të ketë në pronësi një autoambulancë në gjendje gadishmërie, me kohë të plotë.

###

- **Për shërbimin e implantit koklear**

- a. Të ketë të kontraktuar të paktën 1 (një) mjek specialist otorinolaringolog të specializuar për vendosjen e implantit koklear.
- b. Të ketë të paktën 1 (një) bllok operator-reanimacioni, sipas standarteve të Ministrisë të Shëndetësisë.

###

- **Për shërbimin e transplantit të veshkës**

- a. Të plotësojë kriteret e parashikuara në VKM-në nr.206, datë 13.03.2013, lidhur me:
  - Kriteret e vecanta të ndërtimit.
  - Kriteret për personelin mjekësor në qendrën e transplantit.
  - Kriteret për ruajtjen e dokumentacionit të aktivitetit të qendrës.
  - Pajisjet e nevojshme për sallën e operacionit, reanimacionin dhe dhomat e pacientëve.